

Kodi i Sjelljes për Zbatim nga Anëtarët e MKV-s Pyetjet që hasen më shpesh

1. Pse Fondi Global vendosi të hatojë një Kod të Sjelljes për Anëtarët e MKV-së?

Në vitin 2015, Bordi i Fondit Global aprovoi një "[Kudër të etikës dhe integritetit](#)" që u kërkon të gjithë anëtarëve të ekosistemit të Fondit Global të zbatojnë në një Kod të Sjelljes. Kodet e sjelljes tashmë ekzistojnë për Bordin, Stafin e Fondit Global, Zbatuesit, dhe madje edhe Furnizuesit. MKV-t luajnë një rol kritik në qeverisjen e Fondit Global dhe mbikëqyrjen e programit, prandaj është e rëndësishme që anëtarët e MKV-s të demonstrojnë standarde të larta etike - një Kod Sjellje i përcakton këto standarde. Në Fondin Global, kodet e sjelljes kërkojnë miratimin e Bordit, prandaj Kodi MKV-s gjithashtu do të paraqitet për miratimin e Bordit në maj 2018, pas konsultimit me MKV-t. Të gjitha MKV-ve do tu rekomandohet të miratojnë Kodin minimalisht një vit pas miratimit të Bordit, periudhë pas të cilës do të bëhet e detyrueshme.

2. Si mund të nënshkruaj një Kod të Sjelljes nëse unë tashmë punoj për një punëdhënës tjetër?

Kodi i Sjelljes është në përputhje me detyrimet tuaja ekzistuese si një anëtar i MKV-së dhe ka të bëjë me veprimtarinë si Anëtar i MKV-së. Nëse jeni në MKV dhe përmbushni funksionet e anëtarit të MKV-s, atëherë gjithashtu duhet të zbatoni rregullat e angazhimit të MKV-së në përmbushje të rolit tuaj. Nënshkrimi i Kodit të Sjelljes është i ngjashëm me nënshkrimin e një marrëveshjeje konfidencialiteti - mund të angazhoheni për të mbajtur informacione konfidenciale për një organizatë gjatë punës për një tjetër. Zyra e Etikës së Fondit Global është në dispozicion për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje lidhur me Kodin e Sjelljes.

3. Çfarë angazhimesh merren kur nënshkruan Kodin e Mirësjelljes?

Në përmbushje të funksionit tuaj si udhëheqës në komunitetin e shëndetit publik angazhoheni të përmbushni standardet më të larta të etikës dhe integritetit. Kjo do të thotë që angazhoheni (1) të përmbushni detyrën në funksion si anëtar i MKV-s, (2) të veproni në mënyrë të përgjegjshme, (3) të komunikoni në mënyrë transparente, (4) dhe të silleni me integritet. Këto vlera shfaqen në të gjitha kodet e sjelljes së Fondit Global. Kodi shpjegon kuptimin e secilës frazë në kontekstin e MKV-s.

Gjithashtu po angazhoni të zbatoni të njëjtat standarde anëtarët e tjerë të MKV-s, Zbatuesit dhe Stafin e Sekretariatit të Fondit Global. Pra, nëse shihni një çështje, ose keni një pyetje, zotoheni të angazhoheni dhe flisni për këtë, së pari brenda MKV-s dhe nëse çështja nuk zgjidhet, tek Fondi Global. Nëse shihni sjellje të pahijshme, si mashtrim apo korrupsion, në lidhje me Grantet e Fondit Global, rikonfirmoni detyrimin për ta raportuar këtë tek Fondi Global. Kjo detyrë zbatohet për të gjithë në ekosistemin e Fondit Global.

4. Si mundet Kodi i Sjelljes ti fuqizojë rekomandimet e MKV-së?

MKV-s u rekomandohen mënyrat e mëposhtme për të fuqizuar Kodin e Sjelljes:

i. **Trajnimi:** Trainimi i anëtarëve të MKV mbi Kodin. Përgatitja e trajnimit në gjuhën amtare dhe kur ka lidhje të dobët me internetin.

ii. **Çertifikimi:** Pasi të jenë trajnuar, anëtarët e MKV-së duhet të nënshkruajnë se kanë lexuar, kuptuar dhe janë zotuar t'i përmbahen Kodit.

iii. **Komiteti ose Personi Përgjegjës i Etikës:** MKV duhet të emërojë anëtarin (ët) për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Sjelljes, menaxhimin e konfliktit të interesit dhe potencialisht etikën mjekësore.

iv. **Caktimi në pikën 6 tek Kërkesat e Pranimit:** Përfshirja e kërkesave të mësipërme në Udhëzimet e MKV-s duke zgjeruar Kërkesën e Pranimit që aktualisht lidhet me menaxhimin e konfliktit të interesit.

5. Si ndikon ky Kod në menaxhimin e konfliktit të interesit të MKV-së?

Menaxhimi i konfliktit të interesit zë një pjesë të madhe në të vepruarit me integritet, kështu që Kodi i Sjelljes përforcon detyrimin tuaj për të vepruar në përputhje me Politikën e Konfliktit të Interesit. Gjatë konsultimeve, MKV-t kanë shprehur nevojën për mbështetje shtesë në menaxhimin e konfliktit të interesit. Si rezultat, të gjitha trajnimet do të përfshijnë thellim të njohurive mbi menaxhimin e konfliktit të interesit, duke përfshirë ndarjen e praktikave më të mira dhe duke punuar me rastet studimore.

Gjithashtu, rregullimet e mëposhtme do të propozohen në baza të diferencuara sipas karakteristikave të MKV-ve (p.sh., Me Ndikim të Lartë) dhe / ose sipas pozicioneve të caktuara udhëheqëse të MKV-së (p.sh., Kryetari, Zëvendëskryetari, Anëtarët e Komitetit të Mbikëqyrjes, anëtari i komitetit nga PK, . Komiteti ose Personi Përgjegjës i Etikës):

- i. **Deklarimi i konfliktit:** Fondi Global do të ofrojë forma standarde të deklarimit për anëtarët që të raportojnë informacione në lidhje me vetveten, personat e lidhur (p.sh. bashkëshorti, vëllezërit e motrat, prindërit, fëmijët) dhe institucionet e lidhura (punësimi, drejtuesi, përkatësia) lidhur me rolet
- ii. **Partneritetet në Planëzim:** PR-ve aktualisht u kërkohet që të dorëzojnë në Fondin Global "Planet e Marrëveshjeve të Zbatimit" -organogramet e të gjithë zbatuesve të përfshirë në një grant. Anëtarëve të MKV-s do tu kërkohet që të komplotojnë vetë në plane, duke treguar lidhjet e tyre me zbatuesit sipas udhëzimeve të ardhshme të Fondit Global. Këto Plane do tu dorëzohen në Ekipeve për Vendin të Fondit Global.

Gjithashtu do të përshtatet Kriteri 6 i Pranimin në Udhëzime të MKV-së për të kërkuar që MKV-të të përditësojnë Politikën e Konfliktit të Interesit për të pasqyruar procedurat ose kërkesat e reja. Përshtatja gjithashtu do të përfshijë sqarime që anëtarët e Komitetit të Mbikëqyrjes nuk mund të jenë të lidhur me zbatuesit e granteve.

6. Çfarë ndodh nëse dikush më akuzon për shkelje të Kodit të Sjelljes?

Një Kod i Sjelljes mund të zbatohet vetëm nëse gjithësecili mban përgjegjësi për të. Prandaj, diskutimi rreth shkeljeve potenciale të Kodit të Sjelljes duhet të inkurajohet dhe - është shumë e rëndësishme- hakmarrja ndaj ngritjes së shqetësimeve në mirëbesim është një praktikë e ndaluar.

Në mënyrë ideale, nëse dikush ka shqetësime se po shkelni Kodin, duhet ti ngrëjnë ato drejtpërdrejt në praninë tuaj që të mund ta shqyrtoni çështjen dhe ose të jepni sqarime, të kërkonit këshilla ose të rregulloni veprimet tuaja. Megjithatë, ka shumë arsye të tjera të mira pse dikush mund të zgjedhë që të mos u drejtohet drejtpërdrejt. Për shembull, mund të ketë frikë nga hakmarrja për shkak të natyrës së balancës së fuqisë midis jush, ose mund të mos jenë të sigurt nëse shqetësimi i tyre është i vërtetë ose nëse nuk dëshirojnë të prishin marrëdhëniet. Ata duhet të inkurajohen të ngrënë shqetësimet përmes një anëtari apo komisioni neutral që mund të ndërmjetësojë çështjen në mënyrë konstruktive.

MKV-ja është një organ vetëqeverisës që tashmë menaxhon më së shumti problemet e veta. Kodi i Sjelljes është një mjet që duhet t'i lejojë Koordinatorit Vendor të sigurojnë se të gjithë anëtarët janë në dijeni dhe kuptojnë detyrimet e tyre etike. Nëse ngrihen shqetësime, MKV-ja duhet të ndjekë procesin e duhur duke verifikuar faktet dhe duke dhënë mundësi për të dëgjuar të gjitha palët. Së fundmi, duhet të përputhen me përgjigjësitë e MKV-së në mënyrë të drejtë për t'iu përshtatur natyrës dhe shkallës së problemit. Zyra e Etikës e Fondit Global është një burim për MKV-të. Ai siguron këshilla konfidenciale në menaxhimin e sfidave të ndërlidhura me etikën.

Fondi Global planifikon të riformulojë ER6 për të detyruar MKV-të të zbatojnë Kodin e Sjelljes ballazi mes anëtarëve të tyre. Nën këtë riformulim, nëse Fondi Global përcakton që MKV nuk është në gjendje të menaxhojë në mënyrë adekuate shkeljet serioze, kronike apo në shkallë të gjerë të Kodit, do e konsiderojë që MKV-ja nuk është në përputhje me ER6.